



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

MANUAL

Mbi

Proçedurat standarte që duhet të zbatojë punonjësi i policisë së shtetit në marrjen e masave për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e kujdesin për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare

I. Hyrje

Në shoqërinë shqiptare, dhuna në familje çdo ditë e më shumë po bëhet problem që çfaqet në të gjitha format, deri në vrasjen e personave me lidhje familjare. Në vite policia e shtetit këtë fenomen e ka vlerësuar si cdo aktivitet tjetër kriminal, pasi mungonte një legjislacion i veçantë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Këtë boshllëk në legjislacion e mbushi hartimi dhe miratimi i ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i cili, ka për qëllim:

-parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.

-garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

-të zëvendësoje praktikën e mëparëshme, të sqarojë dhe verë në zbatim një praktikë të mirë ku aktorët e përcaktuar në ligj të koordinojnë dhe bashkërendojnë punën e tyre për arritjen e qëllimit final, marrjen e masave ndaj dhunës në familje.

Aktet nënligjore në tërësinë e tyre përfshijnë detyrime institucionale që rrjedhin jo vetëm nga ligji nr. 9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në

marrëdhëniet familjare”, por dhe nga ligji nr.9749 dt. 04.06.2007 “ Për Policinë e Shtetit”.

Manuali ka për qëllim, përcaktimin e procedurave standarte që duhet të zbatohet punonjësi i Policisë së Shtetit që në momentin e parë kur ai përballet me rastin e ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Këto do të rekomandohen në funksion të detyrimeve ligjore që ka policia e shtetit në përgjithësi dhe strukturat e saj në vecanti për të marrë masa efektive në një kohë të shpejtë për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e kujdesin për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

II. Kuptim i përgjithshëm

Përkufizimi i dhunës në familje në kuptimin e nenit 3 të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat:

-“Dhunë” do të kuptojmë çdo veprim apo mosveprim të një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, dhe ekonomik.

-“Dhunë në familje” është çdo akt dhune, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare;

“Pjestarët e familjes” në kuptim të nenit 3, pika 3 të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, do të kuptojmë :

1. Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja; apo ish-bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues;
2. Vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;
3. Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën b;
4. Gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;
5. Vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit;
6. Fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

“Viktima” në rastet e ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare, sipas nenin 3 pika 4 të po këtij ligji, janë personat mbi të cilët është ushtruar dhunë me veprim apo mosveprim nga një person tjetër , që ka sjellë si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, dhe ekonomik .

“Dhunues/e” në rastet e ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, përpara

organeve kompetente, (nenit 3 pika 5 e ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare").

Dhuna në marrëdhëniet familjare në kuptim të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006, konsumuar si figurë në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet edhe në dispozita konkrete :

1. Vrasja (Nenet 76 - 83, 85 të Kodit Penal)
2. Kanosja (Neni 84)
3. Tortura (Nenet 86 dhe 87)
4. Plagosja (Neni 88/b)
5. Plagosja e rëndë me dashje (Neni 88, 88/a)
6. Plagosja e lehtë me dashje (Neni 89)
7. Dëmtime të tjera me dashje (Neni 90)
8. Plagosja e rëndë nga pakujdesia (Neni 91)
9. Plagosja e lehtë nga pakujdesia (Neni 92)
10. Ndërprerja e shtatëzanisë pa pëlqim të gruas (Neni 93)
11. Mosdhënia ndihmë (Neni 97)
12. Shkaktimi i vetëvrasjes (Neni 99)
13. Marrëdhënie seksuale (Nenet 100-107)
14. Vepra të turpshme (Neni 108)
15. Rrëmbimi (Neni 109, 109/a)
16. Trafikimi (Neni 110/1 dhe Neni 114/b, për të miturit 128/b)
17. Dhunimi i banesës (Neni 112)
18. Shfrytëzimi i prostitucionit (Neni 114)
19. Fyerja (Neni 119)
20. Shpifja (Neni 120)
21. Pengimi në ushtrimin e të drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar (Neni 261)
22. Ndërhyrje të padrejta në jetën private (Neni 121)
23. Braktisja (Neni 124)
24. Keqtrajtimi i të miturit (Neni 124/b)
25. Mosdhënia e mjeteve për jetesë (Neni 125)
26. Marrja e padrejtë e fëmijës (Neni 127)
27. Shtrengimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë (Neni 130)

28. Kufizimi i lirisë për të administruar të ardhurat (vjedhja me dhunë/vjedhja - (Nenet 139 dhe 134)
29. Shkatërrimi i pronës ose mirëqenies ekonomike (Nenet 150-154)
30. Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (Neni 275)

Raste të tjera që konsiderohen dhunë në marrëdhëniet familjare janë:

- Pengimi në mbajtjen e mjeteve monetare,
- Përçmimi në mënyra e forma të ndryshme,
- Vendosja e fëmijëve në situata të rrezikshme apo dëshmitarë të dhunës ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes.

III. Proçedurat standarte që duhet të zbatojë punonjësi i policisë në zbatim të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 "për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare",

A- Punonjësi i policisë ndërhyr në rastet e dhunës në familje:

1. Për të respektuar ligjin.
2. Për të parandaluar dhe reduktuar dhunën në familje në të gjitha format e saj nëpërmjet mjeteve që i atribuon ligji nr. 9669 date 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", dhe ligji nr.9749 dt. 04.06.2007 " Për Policinë e Shtetit".
3. Për të garantuar mbrojtje ligjore, veçanërisht siguri, për anëtarët e familjeve që i nënshtrohen dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.
4. Për të ndërprerë veprimet e dhunshme.
5. Për t'i krijuar mundësi rehabilitimi dhunuesit, nëse kjo gjykohet e përshtatshme.
6. Për të parandaluar dëmtimet e rënda dhe vrasjet duke ndërhyrë që në nivelet e para të dhunës.
7. Për të minimizur dhe reduktuar përsëritjen e herpashershme të akteve të dhunës në ambientet familjarere.

B-Detyrat e Punonjësve të Policisë që Shërbejnë në Sallat e Drejtimit dhe Komandimit:

Veprimet e para të punonjësit të policisë që shërben në sallën e drejtimit dhe komandimit në momentin kur merr një telefonatë për dhunë në familje në kuptim të ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", dhe në zbatim të detyrimeve të ligjit nr.9749 dt. 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", janë si më poshtë:

1. Të trajtojë me përparësi çdo telefonatë që përfshin një incident të dhunës në familje, e cila sapo ka nisur apo është në zhvillim e sipër.
2. Të dërgojë menjëherë në vendin e ngjarjes që ka të bëjë me dhunë në familje jo më pak se dy punonjës policie, mundësisht njëri prej tyre të jetë femër.
3. Të vlerësojë telefonatën për rastin e dhunës në familje si rast urgjence për ndihmë të menjëhershme dhe më pas të marrë të gjitha masat për njoftimin dhe dërgimin në vendin e ngjarjes të grupit hetimor për kryerjen e veprimeve procedurale.
4. Të mënjanojë çdo koment që e bën viktimën përgjegjëse apo që ul rëndësinë e incidentit.

C- Veprimet e Punonjësve të Policisë që Shërbejnë në Sallat e Drejtimit dhe Komandimit gjatë zhvillimit të bisedës në telefon me viktimën apo persona të tjerë:

Në sallën e drejtimit dhe komandimit të jenë të regjistruar numrat e kontaktit (telefon e fax) të OJF-ve, qendrave shëndetësore, sociale, etj, që trajtojnë çështjet e dhunës në familje në juridiksionin e drejtorisë dhe komisariateve të policisë, sipas memorandumeve të bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet tyre.

Punonjësit e policisë që shërbejnë në sallat e drejtimit dhe komandimit kanë detyrë dhe përgjegjësi:

- të kenë parasysh ndjeshmërinë e viktimës,
- të vlerësojnë informacionin nga personat që marrin në telefon herë pas here, sepse ata (personat telefonues) janë personat që përballen me këto raste të dhunës familjare.
- të udhëzojë personelin përkatës që të shkojë në vendin e ngjarjes, për t'i ardhur viktimës në ndihmë.
- të mbledhë informatat e para gjatë marrjes së telefonatës. Informacioni fillestar i regjistruar nga pranuesi i thirrjes, mund t'u japë informacion të rëndësishëm grupit hetimor, po ashtu, këto informata ndihmojnë në procesin gjyqësor,
- t'i drejtojnë pyetje telefonuesit gjatë bisedes duke mbajtur shënimet përkatëse dhe të sigurojnë informacionin e mëposhtëm:

1. Si quhet telefonuesi?
2. A është telefonuesi vetë viktimë?
3. Nëse jo, a ka asistuar telefonuesi në këtë incident?
4. Cila është situata urgjente?
5. Kur ka ndodhur incidenti apo është duke u zhvilluar në këtë moment?
6. Ku po zhvillohet situata urgjente - adresa e saktë ose e orientuar (në afërsi-përballë-majtas-djathtas, etj) me objekte të tjera publike?
7. A ka të dëmtuar për të sjellë ndihmë të parë mjekësore ?
8. A ka nevojë për ambulancë - nëqoftëse po-menjëherë njofton dhe dërgon ambulancën për ndihmë mjekësore.

9. A ka nevojë për zjarrfikëse-nëqoftëse kemi të shoqëruar dhunën me venie zjarri, njoftimi i menjëhershëm i zjarrfikësve për të dhënë ndihmën e duhur.
10. A janë përdorur armë?
11. Të çfarë lloji?
12. Cili është dhunuesi, a njihet nga telefonuesi?
13. Cila është marrëdhënia ndërmjet telefonuesit dhe dhunuesit?
14. Ku gjendet dhunuesi tani?
15. Cili është përshkrimi fizik i dhunuesit?
16. Ndonjë nga personat e përfshirë në këtë dhunë a ka përdorur lëndë narkotike apo alkool?
17. Ka ndonjë urdhër mbrojtjeje ndaj dhunuesit?
18. A ka qenë policia në këtë adresë apo tek këta persona më parë?
19. A ka dëshmitarë të tjerë?
20. Si quhen ata?
21. A ka fëmijë aty?
22. Sa vjeç janë?
23. Mos ndërprisni marrjen e telefonatave mbi rastin e Dhunës në Familje në qoftë se ju merrni ndonjë telefonatë që ju thotë që nuk ka nevojë për policinë të arrijë në vendin e ngjarjes. Kjo mund të ndodhë sepse telefonata mund të jetë bërë nga një person që është kërcënuar për të bërë një gjë të tillë.
24. Njoftoni strukturën policore përgjegjëse mbi telefonatën që keni marrë, dhe lejojeni që të vazhdojë detyrën e saj për verifikimin e gjëndjes të viktimës.
25. Në qoftë se viktimja është sulmuar seksualisht, marrësi i telefonatës duhet t'i thotë viktimës që të mos lahet ose të ndryshojë rrobat. Çdo shpërthim emocional i viktimës dhe çdo informacion që viktimja i jep punonjësit të policisë, duhet të regjistrohet. Në këto raste t'ë shfrytëzohen memorandumet e bashkëpunimit për të siguruar ardhjen në vendngjarje dhe të punonjësve të qendrave të ndryshme sociale e OJF-ve që merren me trajtimin e viktimave të dhunës seksuale.

D. Përgjegjësitë dhe detyrat e Strukturave të rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet:

Përgjegjësitë e specialistëve të Strukturave të rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet në rastet e trajtimit të dhunës në marrëdhëniet familjare:

- të reagojnë menjëherë ndaj njoftimeve për dhunë familjare, pa marrë parasysh a është raportim i menjëhershëm apo i vonuar,
- të vlerësojnë faktin se janë personat e parë "fizik" në vendin e ngjarjes që i referohet telefonata për dhunën në familje,
- janë personat më të rëndësishëm në situatat e dhunës familjare,
- luajnë një rol kryesor në sigurimin e provave,
- luajnë rol kryesor për bashkëpunimin me viktimën për të mundësuar më vonë një rast eventual për ndjekje penale,

1-Detyrat e specialistëve të Strukturave të rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet gjatë afrimit për në vendin e ngjarjes:

Specialistët e Strukturave të rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet duhet të marrin informacionin që disponon marrësi i telefonatës para se të arrijnë në vendin e ngjarjes dhe duhet ta njoftojnë atë kur arrijnë në vendngjarje.

Momenti më i rrezikshëm për specialistët e Strukturave të rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet është kur ai/ajo i afrohet vendit të ngjarjes, konkretisht vendbanimit.

Në çdo rast duhet të dërgohen jo më pak se dy punonjës policie.

2-Procedurat që duhet të zbatohen specialistet e Strukturave të rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet ndërsa i afrohen vendbanimit:

- Punonjësi i policisë kur i afrohet vendit të ngjarjes, duhet të shmangë përdorimin e borisë së mjetit dhe dritave të emergjencës.
- Boria dhe dritat duhet të përdoren vetëm atëherë kur është e nevojshme që të rritet shpejtësia e levizjes së mjeteve të tyre.
- Nuk duhet të parkohen makinat e policisë para shtëpisë, por me larg, dhe të gjitha veprimet mundësisht të kryhen duke ruajtur privatësinë e denoncuesve.
- Punonjësi i Policisë duhet të jetë vigjilent për personat që mund të largohen nga vendi i ngjarjes si dhe për armët që mund të përdoren nga dyert, dritaret apo nga automjetet përreth.

3-Pas trokitjes në derë dhe pas ballafaqimit me ndonjë banor të asaj shtëpie, punonjësi i policisë duhet :

- Të prezantojë veten si punonjës policie, të sqarojë pse ndodhet aty dhe të kërkojë të hyjë në shtëpi.
- Të kërkojë të shohë viktimën dhe të mos tregojë emrin e personit që ka bërë thirrjen.
- Nëse punonjësi i policisë has rezistencë për të hyrë në vendin e ngjarjes, (kryesisht banesa,lokale etj), ai duhet të jetë i prerë në kërkesën e tij për ta parë viktimën dhe për të biseduar pa praninë e dhunuesit dhe familjarëve të tjerë.

- Nëse punonjësit të policisë i pengohet takimi me viktimën atëherë ai duhet të kontaktojë me operatorin që ka marrë telefonatën dhe t'i kërkojë atij ndihmë për punonjës ose mjete të tjera policie, me qëllim kryerjen e detyrave të tij funksionale për rastin në fjalë.

4-Detyrat e specialistëve të Strukturave të rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet, si dhe atyre të Krimeve të Rënda me të mbërritur në vendngjarje:

1. Punonjësit e policisë duhet të trokasin në derë vetëm pasi kanë kontrolluar vendin përreth dhe sigurohen se nuk i kërcënohet jeta .
2. Punonjësit e policisë duhet të mbajnë distancë për të vepruar (reaguar) nëse ndodh ndonjë situatë e papritur.
3. Të përshtasin reagimin e tyre sipas intensitetit të sulmit të kryer nga dhunuesi, bazuar në informacionin që u është dhënë nga salla e drejtimit dhe komandimit, por dhe çfarë ka konstatuar në vendin e ngjarjes.
4. Të vlerësojnë situatën dhe të kërkojë forca të tjera policore për të zgjidhur atë.
5. Nëse dhunuesi ka ikur nga vendi i ngjarjes, të njoftohet sa më shpejt salla e drejtimit dhe komandimit dhe të merren masa për të parandaluar kryerjen e ndonjë veprë penale nga dhunuesi.
6. Të vendoset rregull duke e marrë situatën nën kontroll, duke vlerësuar ndarjen e palëve të përfshira në incident.
7. Të konfiskohet çdo armë, (qoftë edhe me leje) e gjetur në vendin e ngjarjes, si në rastet kur është në cilesinë e provës materiale, ashtu dhe në raste të tjera, me synimin për të parandaluar përdorimin e saj nga dhunuesi.
8. Të tregohet kujdes në mbledhjen e provave proceduriale, të ndihmohet dhe sigurohet ndihmë mjekësore për personat e dëmtuar.
9. Të sigurohet vendi i ngjarjes sipas metodikave të "Ruajtjes së vendit të ngjarjes".
10. Të ndahen fizikisht dëshmitarët e rastit dhe të krijohen kushte për intervistimin e tyre.
11. Të shënohen të gjitha informatat e dhëna sa më saktë që është e mundur. Të evidentohen dhe vlerësohen informacionet e dhëna nga mjeku i urgjencës,

- nga punonjesi social i Bashkisë ose Komunës dhe i OJF-ve, si nëpërmjet intervistimit, ashtu dhe dërgimit me shkrim të informacioneve prej tyre.
12. Të mblidhen dhe evidentohen të gjitha provat duke përfshirë fotografitë e dëmtimeve fizike dhe të shkatërrimeve të pasurisë.
 13. Të merren masa për kapjen e personit dhunues, nëse është larguar nga vendi i ngjarjes.
 - Të kontrollohet vendi për ta kapur dhunuesin.
 - Të merren informacione për lëvizjet dhe vendndodhjet e mundshme të dhunuesit.
 15. Të hartohet dokumentacion i plotë sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale dhe përcillen në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor .
 16. Të përdoren të gjitha mjetet dhe mënyrat e mundshme, për ta mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar keqtrajtimet e tjera që mund ta përshijnë duke ndërmarrë hapat e mëposhtëm:
 - Nëse nuk ka zgjidhje tjetër, bëni të mundur shoqërimin e viktimës dhe të fëmijëve apo pjestarëve të tjerë të familjes në një vend të përshtatshëm të sigurt. Të shfrytëzohen memorandumet e bashkëpunimit me qendra dhe OJF që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat e dhunës në familje, duke respektuar vullnetin e viktimës.
 - Siguroni mbrojtje për personin e raportimit të dhunës , sipas ligjit "Për mbrojtjen e dëshmitarëve".
 - Ndihmoni viktimën, që të marrë sendet e nevojshme personale, në rast se vendos të largohet nga banesa e përbashkët.
 - Qëndroni në banesë, për t'i paraprirë kthimit të dhunuesit në banesën e përbashkët për marrjen e sendeve të tij ose të viktimës.
 - Përkujdesuni për sigurinë e fëmijëve.
 17. Te përfundohen të gjitha raportet e incidentit/vepres penale në kohë, duke shfrytëzuar dhe informacionet e marra nga qendrat mjekësore, OJF-të, punonjësit sociale dhe ja dërgoni eprorit përgjegjës, i cili ia përcjell menjëherë shefit të Sektorit Kundër Krimeve të Rënda.

IV -Detyrat gjatë hetimit dhe intervistimit:

1-Punonjësi i policisë për rastet e dhunës në familje duhet :

1. T'i japë përparësi rasteve të dhunshme, (kundrejt rasteve jo të dhunshme) duke garantuar sigurimin e mbrotjes së të gjitha palëve të përfshira,

2. Të ndihmojë dhe kontribuojë që autori të kapet sa më shpejt që të jetë e mundur,
3. Të përgatisë dokumentat brenda afateve proceduriale për ndjekje penale,
4. Të bashkëpunojë e ndihmojë viktimën dhe dëshmitarin ,
5. Të mbrojë viktimat dhe dëshmitarët nga kërcënimet e ndryshme,
6. Të koordinojë në vazhdimësi me Gjykatën e Shkallës së Parë, për të gjitha "Urdhërat e Menjëhershëm të Mbrojtjes" dhe "Urdhërat e Mbrojtjes" të nxjerra prej saj, për të zbatuar në kohë detyrimet ligjore,

2-Punonjësi i policisë gjatë hetimit ne vendngjarje kryen detyrat si më poshtë:

1. Të kryejë një hetim të plotë dhe të përgatisë një raport, pavarësisht nga dëshira e viktimës apo prania ose mungesa e të dyshuarit,
2. Sipas rastit, të afrohet me kujdes në vendngjarje dhe të shohë e dëgjojë se çfarë po ndodh përpara se të bëjë të ditur praninë e tij,
3. Të përcaktojë vendndodhjen dhe kushtet e viktimës dhe të dyshuarit,
4. Të përcaktojë nëse është përdorur armë, ose të verifikojë në banesë apo ambjentin përreth nese mbahen armë të fshehura nga dhunuesi ,
5. Të japë ndihmë për palët e dëmtuara dhe nëse e vlerëson, njofton një ambulancë,
6. Të evidentojë emrin e mjekut që ka vizituar ose i ka dhënë ndihmën e parë viktimës, për të siguruar dokumentacionin përkatës shëndetsor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë,
7. Të përcaktojë nëse ka persona të tjerë në banesë apo ndërtesën ku është ushtruar dhuna,
8. Të mbajë veç të dyshuarin, viktimën dhe dëshmitarët përpara se t'i pyesë ata,
9. Të mos bëjë interpretime subjektive, por të pasqyrojë në proces-verbal, të gjitha thëniet e të intervistuarit, që ndihmojnë në hetimin e rastit,
10. Të dokumentojë dhe fotografojë të gjitha dëmtimet trupore. (Kodi i Pr. Penale neni 188),
11. Të fiksojë sipas të gjitha rregullave proceduriale gjendjen statike të vendngjarjes (proces verbal, fotografi dhe skicë),
12. Të fiksojë me procesverbal, fotografi apo filmim, armët e mjete të tjera të ushtrimit të dhunës me cilësinë e provave materiale. Përshkrimi i tyre në proces verbal të bëhet i detajuar,
13. Të marrë informacion se kush njoftoi sallën e drejtimit dhe komandimit të policisë. Nëse ka patur njoftim të tillë të kryejë verifikimet përkatëse për ditën kur është regjistruar telefonata si dhe të njihet me masat paraprake të marra,

14. Të marrë informacion për fqinjët, pasi ata mund të jenë familjarë apo rreth farefisnor i familjes ku është ushtruar dhunë, që do të ishte element shumë i rëndësishëm për veprimet e mëtejshme të policisë për njohjen e situatës.
15. Të vlerësojë gjendjen emocionale të të gjithë personave në konflikt. Të merren në konsideratë informacionet e marra nga mjekët, punonjësit socialë të bashkive, komunave e OJF-ve, si pjesë e informacionit të siguruar për hetim.

3. Intervistimi

A. Intervistimi i viktimës:

Punonjësi i policisë që merret me hetimin:

- Duhet ta bëjë viktimën që të ndjehet se deklarata e tij është e rëndësishme. Punonjësi i policisë duhet të tregojë kujdes për viktimën. Zëri i tij, shikimi dhe fjalët që ai zgjedh, do të shërbejnë për të transmetuar këtë mesazh se ai "ndodhet aty për të ndihmuar".

- Duhet të tregojë kujdes për sigurinë e viktimës, mund ta ndihmojë atë të heqë frikën dhe të jetë më e gatshme për të bashkëpunuar me zbatuesit e ligjit. Gjithmonë duhet patur parasysh se, viktimës mund t'i jetë thënë nga dhunuesi se, nëse ajo kërkon ndihmë, askush nuk do ta ndihmojë atë. Binde viktimën se prioritet për ju është siguria e saj dhe ajo nuk është fajtores.

B. Intervistimi i të dyshuarit: Gjatë intervistimit të të dyshuarit:

1. Intervistojë të dyshuarin në një dhomë të ndarë nga viktimë,
2. Mundohu që ta qetësosh të dyshuarin nëse ai është i nervozuar,
3. Të dyshuarit duhet t'i bëhen të ditura të drejtat që ai gëzon sipas ligjit,
4. Mos bëni deklarata akuzuese, të cilat mund ta vendosin të dyshuarin në pozitë mbrojtëse. Synoni që i dyshuari të bashkëpunojë me ju gjatë intervistës,
5. Duhet të keni parasysh gjendjen e tij emocionale,
6. E lini të dyshuarin të tregojë ngjarjen vetë, para se ta ballafaqoni me informacionin që e konflikton atë,
7. Dokumentoni (shënoni) të gjitha deklaratimet e tij,
8. Të mos i tregohet të dyshuarit edhe kur pyet, kush e ka njoftuar policinë.

C. Intervistimi i dëshmitarëve:

1. Merrni në pyetje të gjithë dëshmitarët veç e veç,
2. Identifikoni dëshmitarët dhe marrëdhëniet e tyre me viktimën dhe të dyshuarin,
3. Rregjistroni informacionin mbi emrat, adresat, numrat e telefonit dhe kontaktin e emergjencës, për çdo dëshmitar të intervistuar,

4. Mbani shënime rreth sjelljes së dëshmitarëve dhe merrni deklaratë me shkrim nga ata,
5. Pyesni fqinjët nëse ata kanë dëgjuar ose parë diçka,
6. Në bazë të informacioneve të marra nga dëshmitarët, mundohuni që të kuptoni nëse ata janë në dijeni të rastit në fjalë apo rasteve të mëparshme të dhunës në familje.

D. Intervistimi i fëmijëve:

Nuk është e thënë që fëmijët të kenë qenë dëshmitarë okularë në të njëjtën dhomë. Edhe në qoftë se viktimë ose i dyshuari thonë që fëmijët ishin sipër apo në një dhomë tjetër duke fjetur, ka shumë të ngjarë që ata të jenë zgjuar nga incidenti dhe zhurma, dhe mund të japin një informacion shumë të vlefshëm për atë që kanë parë apo dëgjuar.

Kujdes në marrëdhënjet me fëmijët. Kujdes Komunikimi me ta !

Fillimisht bëhet një komunikim i thjeshtë. Pyetet për moshën, shkollën, ecurinë në mësim dhe kur konstaton një qetësim psikologjik të fëmijës mund të pyetet se:

Çfarë ndodhi?

1. Kush ushtroi dhunë?
2. Ku ishe ti kur ndodhi kjo?
3. Kur ndodhi kjo?
4. A ka ndodhur dhe herë të tjera ?

(Të kihet parasysh domosdoshmëria e pranisë së mësuesit, psikologut, punonjësit social, etj. gjatë procesit të intervistimit të tyre)

V. Disa rregulla të përgjithshme;

KUJDES !

- Reagoni menjëherë dhe maksimalisht me të gjitha mjetet që dispononi, të komunikimit dhe organizimit policor. Gjithshka evidentoheni me shkrim në "Regjistrin për evidentimin e ngjarjeve kriminale të ndodhura".

- Asnjëherë mos i besoni kujtesës.

- *Ligji penal në rastet e dhunës në familje duhet të zbatohet në të njëjtën mënyrë si në çdo rast kur ndodh një krim.*

- **Punonjësi i policisë gjatë trajtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje nuk duhet të ndikohet nga :**

- Marrëdhënia apo gjendja civile e të dyshuarit dhe viktimës (të martuar, divorcuar, bashkëjetojnë, etj),
- Nëse i dyshuari jeton apo jo në banesën e viktimës,
- Mungesa e një Urdhëri- Mbrojtjeje,
- Mundësia e pasojave financiare të arrestimit,
- Gjendja emocionale e viktimës ose të dyshuarit (i dyshuari është zakonisht mjaft i qetë dhe nën kontroll, ndërsa viktimja mund të jetë e shqetësuar pasi ka përjetuar dhunë),
- Mungesa e plagëve të dukshme tek viktimja (shumë dëmtime janë të brendshme dhe nuk duken përpara 24-48 orëve),
- Vendndodhja e incidentit, psh. pronë publike apo private,

KUJDES, gjatë komunikimit me viktimën !

1. Të mos spekulohet me faktin, se nuk mund të ngrihen dot akuza ndaj dhunuesit,
2. Punonjësi i policisë nuk duhet të bëjë sugjerime apo kërcënime, për të dekurajuar viktimën për të bërë kallëzim . Ndalohen shprehje apo pyetje të tilla si më poshtë :

- *Ju e dimi se ne duhet ta arrestojmë bashkëshortin tuaj dhe ai nuk do të jetë në gjendje të punojë,*
- *Kjo do ta nxehë atë më shumë,*
- *Na duhet t'ju arrestojmë të dyve dhe kush do të kujdeset për fëmijët,*

Në rast se gjatë konfliktit në prezencën tuaj të dyja palët pretendojnë se është përdorur dhunë, evidentoni përgjigjet në mënyrë të saktë për pyetjet e mëposhtme:

- Nëse njëra nga palët në konflikt ka frikë nga pala tjetër ?
- A e ka përshkallëzuar nivelin e dhunës ndonjëra nga palët?
- A ishte njëra nga palët më e madhe dhe më e fuqishme se tjetra?
- A ka patur incidente të mëparshme të dhunës të njerës prej palëve ndaj tjetrës, apo ndaj personave të tjerë ?
- A ka ndonjë rast të mëparshëm ku njëra nga palët ka qënë dhunuesi?
- A është dëmtuar njëra nga palët më shumë sesa tjetra?

- A ka dëmtime që duken të jenë shkaktuar, kur viktimë ka qenë në kushtet e mbrojtjes së nevojshme ose nevojës ekstreme, (sipas neneve 19 dhe 20 të Kodit Penal) psh; të kafshuara, të djegura, gërvishtje, etj ?

VI -Detyrat e punonjësve të policisë për zbatimin e urdhërave të mbrojtjes.

A- Urdhërat e mbrojtjes. Përgjegjësitë e punonjësit të policisë .

Nëse nuk ka "Urdhër Mbrojtjeje", ose "Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje" punonjësi i policisë duhet ta bëjë me dije viktimën, për masat mbrojtëse që i garantohen në zbatim të ligjit Nr 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", si dhe mundësinë e nxjerrjes së një urdhëri të tillë nga gjykata.

- Nëse ka "Urdhër Mbrojtjeje", ose "Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje", punonjësi i policisë duhet të lexojë me kujdes urdhërin për të parë se çfarë masash mbrojtjeje i siguron ai viktimës dhe çfarë kufizimesh përcakton për të dyshuarin,
- Nëse i dyshuari ka shkelur "Urdhërin e Menjëhershëm të Mbrojtjes", ose "Urdhërin e Mbrojtjes", punonjësi i policisë duhet ta arrestojë atë, në përputhje me Nenin 320 të Kodit Penal për "Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës".

B- Raporti me shkrim për incidentin. Përgjegjësitë e punonjësit të policisë për përpilimin e tij.

- Të dokumentojë çdo element për secilën vepër, duke mbajtur parasysh faktin se mund të kemi më shumë se një për shkak të përkeqësimit të situatës,
- Të dokumentojë shkeljen e urdhërit të mbrojtjes, nëse ka të tillë,
- Të dokumentojë në procesverbal dhe fiksojë me fotografi çdo dëmtim fizik dhe përshkrime të shkruara të tyre,
- Të dokumentojë dhe fiksojë sipas metodikave prova fizike si psh. dëmtime të ndryshme fizike në mure, dyer e dritare të thyera, mobilje të dëmtuara, etj,
- Të dokumentojë incidentet e mëparshëm të raportuara ose jo pranë strukturave të policisë,
- Të përshkruajë (citojë) në detaje dhe jo në mënyrë të përmblodhur fjalët e viktimës, të dyshuarit dhe dëshmitarëve,
- Të përshkruajë gjëndjen emocionale të të gjitha palëve në incident,
- Të përcaktojë nëse ka pasur fëmijë, të moshuar apo persona me aftësi të kufizuara të pranishëm apo të lënduar gjatë incidentit,

- Të fiksojë dhe dokumentojë në proces verbalin e pyetjes, nëse viktimat ka qënë shtatzënë në momentin e incidentit,

C- Përgjegjësitë e punonjësve të policisë së shtetit në mbrojtje të viktimave:

Ministria e Brendshme ka për detyrë krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë Drejtorive të Policisë dhe trainimin e efektivave të policisë që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje. (Neni 9 i ligjit)

Drejtoritë e policisë janë një prej autoriteteve përgjegjëse sipas ligjit. (Neni 5 i ligjit)

Të gjitha autoritetet duhet të bashkërendojnë shërbimet, të caktojnë personat përgjegjës, t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat, të mbajnë raportet përkatëse dhe t'i mbrojnë viktimat nëpërmjet informimit, sigurimit të transportit ose vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën. (Neni 8/3 i ligjit).

Sipas ligjit kundër dhunës në familje, policia mund të paraqesë kërkesë për urdhër mbrojtje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje. (Neni 13) Policia duhet të tregohet jashtëzakonisht e kujdesshme në zbatimin e kësaj dispozite në mënyrë që viktimës t'i bëhen me dije të drejtat për mbrojtje.

Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet pranë komisariatit më të afërt të policisë. (Neni 14). Struktura policore duhet të kontaktojë prokurorin e shërbimit të radhës, i cili mbas komunikimit me gjykatësin merr urdhërin e mbrojtjes. Një kopje e këtij urdhëri menjëherë duhet t'i dërgohet komisariatit të policisë dhe viktimës kudo që është vendndodhja e tyre.

Raportet e policisë, proces verbalet e mbajtura prej saj, mund të paraqiten si prova në gjykatë. (Neni 16)

Viktima dhe të tjerët mund t'i drejtohen me anë të një kërkesë komisariatit të policisë dhe organet e policisë kanë për detyrë të bëjnë konstatimet përkatëse si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. (Neni 9, 14/2)

Gjykata, brënda 24 orësh pas lëshimit të urdhërit, i dërgon një kopje komisariatit të policisë. (Nenet 19, 17, 22)

Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje që është paraqitur nga policia, gjykata mund të kërkojë që punonjës të policisë të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime për ngjarjen dhe rrethanat e saj. (Neni 18, 16)

Punonjësit e policisë të cilët nuk veprojnë në zbatim të këtij ligji, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale duke aplikuar sanksionet e përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të K.P. (Neni 8/5 i ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006)

D- Përgjegjësi e punonjësve të policisë në zbatimin e urdhërave të mbrojtjes:

-Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë. (Nenet 14/6, 23 i ligjit).

-Urdhëri fillon të zbatohet menjëherë nga drejtoritë e policisë, ndërmjet të tjerëve. (Nenet 14/6, 23).

-Punonjësit e policisë, ndërmjet të tjerave të marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse. (Neni 23)

-Në rast të moszekutimit vullnetar nga subjektet, të cilëve iu komunikohet vendimi, aplikohen sanksionet përkatëse të parashikura në këtë ligj ndaj personave moszbatues të ligjit konform neni 320 të Kodit Penal "Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës"(Neni 23 i ligjit nr. 9669 date 18.12.2006) Është e rëndësishme që policia të veprojë me shpejtësi në raste të tilla sepse kjo është një kohë tepër e rrezikshme për viktimat.

-Lëshimi i urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhërit të mbrojtjes me vendim gjykate nuk i ndalon palët e interesuara të nisnin procesin penal, përsa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale. (Neni 24 i ligjit nr. 9669 date 18.12.2006) Kjo është shpesh mjaft e rëndësishme si mekanizëm mbrojtjeje për viktimat.

VII. Vlerësoni rast pas rasti

Disa nga aspektet specifike që duhen vlerësuar në rastet e dhunës në familje:

-Dhuna, mos është pasojë e një divorci ndërmjet bashkëshortëve ?

-Shpesh dhunuesi e rrit shkallën e dhunës në momentin e shkurorëzimit për shkak të frikës së humbjes së kontrollit ndaj viktimës.

-Prania e një arme zjarri me leje ose jo në banesën ku ndodh incidenti është paralajmërim i një rreziku ekstrem.

-Kujdes momentet e para kur doni të bllokoni armën. Ky veprim të bëhet mbi bazën e një dokumentacioni korrekt ligjor.

-Përpara se ta ktheni armën, kontrolloni nëse ka një urdhër mbrojtjeje kundër personit dhe nëse po, mos ia ktheni armën deri në përfundimin e kohës së urdhërit të mbrojtjes, edhe atëherë me urdhër gjykate. (Kodi i Procedurës Penale neni 217)

-Drejtojini viktimat tek OJF-të lokale që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje.

VIII. Vlerësoni legjislacionin penal dhe atë procedural gjatë trajtimit të rasteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje

A- Referime ligjore në legjislacionin penal .

Neni 17- "Përgjegjëshmëria për shkak të gjendjes mendore"

Shpesh dhunuesi pretendon se ai nuk është përgjegjës, sepse nuk mundi t'i kontrollonte veprimet e tij pasi e shoqja e kishte nxehur. **Kjo nuk është bindëse për të bërë një mbrojtje.**

Pyeteni se si sillet ai kur nxehet në ambjentet shoqërore. Vlerësojini këto momente mbasi ai këta nuk i godet. Viktimë e dhunës është vetëm bashkëshortja e tij.

Neni 18 - "Kryerja e veprës penale në gjendje të dehur"

Praktika ka evidentuar se dhunuesi shpesh pretendon se nuk është përgjegjës pasi në kohën e ushtrimit të dhunës ka qenë në gjendje të dehur. Kjo në asnjë rast nuk mund të shërbejë si rrethanë për të justifikuar dhunën e ushtruar, përkundrazi përkeqëson pozitën e dhunuesit.

Në rast se konstatooni se ndodheni para një fakti ku dhunuesi është në gjendje të dehur, menjëherë masni përqindjen e alkoolit tek dhunuesi në vendngjarje apo më vonë në komisariat dhe këtë veprim fiksojeni sipas të gjitha rregullave procedurale.

Neni 50 - "Rrethanat rënduese"

Jemi përpara rrethanave rënduese:

-në ato raste kur vepra është kryer ndaj grave shtatzëna, fëmijëve apo personave të tjerë që nuk janë të gjendje të mbrohen si, të moshuarve ose personave me aftësi të kufizuar.

- kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare,

- kur vepra penale është kryer në bashkëpunim,

- kur vepra penale është kryer më shumë se një herë,

- kur vepra penale është kryer duke përdorur armë, municione luftarake, lëndë plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive

Neni 93 - "Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas"

Nëse dhunuesi gjatë veprimeve të tij i ka drejtuar gjuajtjet drejt stomakut, sigurohuni nëse jeni para një shtatëzanie, për të cilën dhunuesi është bërë agresiv. Sigurohuni të dokumentoni nëse e dëmtuara është shtatzënë, dhe çfarë dëmtimesh janë shkaktuar nga dhuna e ushtruar.

Nenet 102-107 - Marrëdhëniet seksuale

Për të gjitha veprat seksuale, pyesni nëse viktimja ka shprehur dëshirën apo jo. Thjesht fakti se ajo është bashkëshortja apo ka kryer marrëdhënie seksuale edhe më parë, nuk mjafton për të thënë se ajo ka shprehur dëshirën. Vlerësojeni këtë situatë me kujdes dhe rast pas rasti.

Nenet 134 - "Vjedhja" dhe 150 - "Shkatërimi i pronës".

Në të gjitha rastet e vjedhjeve dhe shkatërrimeve të pronës, punonjësi i policisë duhet të ketë parasysh faktin se prona e përbashkët u përket njëloj të dyja palëve

dhe njëra palë nuk ka të drejtë ta marrë, mbajë apo ta shkatërrojë atë. (Kodi i familjes - Neni 73)

B- Referime ligjore në legjislacionin procedural penal .

Neni 251 - "Arrestimi në flagrancë"

Edhe nëse krimi i kryer apo i mbetur në tentativë nuk plotëson kriteret e paragrafeve 1 ose 2, ekzistenca e një urdhëri mbrojtjeje duhet t'i plotësojë kriteret e paragrafit 3 për të lejuar arrestimin e menjëhershëm. Nëse punonjësi i policisë është në dijeni të rasteve të mëparshme të dhunës në familje ndërmjet të njëjtëve persona, ose për shkak të rrezikut të njohur se dhuna në familje vjen duke u rritur, kjo duhet të mjaftojë për të lejuar arrestimin në flagrancë sipas paragrafit 3 të këtij neni **"Kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, specialistet e Sektorit kundër Krimeve të Renda kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2"**

Neni 285 - "Heqja dorë nga e drejta e ankimit" dhe neni 286 - "Tërheqja e ankimit".

Punonjësi i policisë duhet të vlerësojë dhe verifikojë rrethanat që kanë shtyrë viktimën të heqë dorë nga e drejta për kallëzim apo kërkon të tërheqë kallëzimin.

Kjo situatë krijohet në rastet kur ndaj të dhunuarës ushtrohet presion, kërcënime nga dhunuesi. Punonjësi i policisë duhet të vlerësojë rastin dhe mbrojtur viktimën nga përsëritja e dhunës.

K u j d e s !

Heqja dorë nga kallzimi nuk përbën shkak për mosnxjerrjen e urdhërit të mbrojtjes

Zëvendës drejtor i Përgjithshëm
Agron KULICAJ

Zevendesdrejtor i Përgjithshëm
Rasim BORISHI

Drejtori kundër Krimeve të Renda
Drejtues i Pare Tonin VOCAJ

Drejtori i Rendit Publik
Drejtues i Pare Nazmi Kotarja